

MIRATOHET  
SEKRETARI I K.K.T.K.M-së  
ARTA DOLLANI

## SPECIFIKIME TEKNIKE


PROJEKT RESTAURIMI URA E GLINËS NË FSHATIN  
GRAPSH, DROPULL I POSHTËM

Llambrino  
Baballeku

Digitally signed by Llambrino  
Baballeku  
Date: 2021.02.02 12:01:14 +02'00'

Tirane 2021

PROJEKT RESTAURIMI URA E GLINËS NË FSHATIN GRAPSH, DROPULL I POSHTËM



## SPECIFIKIME TEKNIKE

### SEKSIONI 1.

#### 1. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

##### 1.1. Kriteret e restaurimit

1. Ruajtja e vlerave autentike që paraqet monumenti (Kompozimi vëllimor, elementët arkitektonikë).
2. Respektimi i fazave të ndryshme të ndërtimit.
3. Konsolidimi i pjesëve të dëmtuara dhe zëvendësimi i elementeve tepër të degraduar të cilët nuk e kryejnë më funksionin e tyre.

*REFERENCAT:* Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi të referencave të zgjeruara. Botimet që janë të referuara në tekst janë të përcaktuara vetëm përgjérat bazë.

##### Ligjet dhe Normat e aplikuara shqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit”, VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.
- Ligjet Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

##### 1.2. Njësité matëse


Në përgjithësi njësítë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Kg dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.“.

##### 1.3. Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë Mbikqyrësi i punimevet një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në objekt deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban Mbikqyrësi i punimeve duhet të përfshijë:

- vizatime që tregojnë rregullimin e përgjithshëm të terrenit dhe urës dhe të ndonjë strukture tjeter të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim,
- detaje të vendosjes së strukturave të përkohshme (skeleri, etj.),
- plane të tjera që ai propozon për përfundimin e të gjitha punëve,



- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar,
- supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar punimet permanente është temë për t'u rregulluar dhe miratuar nga Mbikqyrësi i punimeve, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga Mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

#### **1.4. Punime të gabuara**

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikkime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

#### **1.5. Tabelat njoftuese, etj.**

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabelat, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

#### **1.6. Autorizimet me shkrim**

“Rregullat me shkrim” do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkua, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rendësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësi i punimevet do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

#### **1.7. Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)**

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhornohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikqyrësi i punimevet çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali më i madhi do të dorëzohet në kopje letër dhe firmosen nga drejtuesi teknik, inxhinieri i kantierit. Vizatimet e riprohuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksionit mbajtës të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit.



Si përfundim, kopjet e riproduara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyrësi i punimevet për aprovim. Vizatimet, “siç është zbatuar”, të aprovuara, do të bëhen pronë e Punëdhënësit dhe një kopje originale do të depozitohet në Arkivën e IKTK-së.

#### **1.8. Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libresa e masave**

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi i punimeve, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

#### **1.9. Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve**

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Mbikqyrësi i punimevet për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi i punimeve.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Mbikqyrësi i punimeve. Mbikqyrësi i punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësi i punimeven dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësi i punimevet për të bërë këto pranime.

#### **1.10. Mostrat**


Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Mbikqyrësi i punimeve për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësi i punimevet.

#### **1.11. Zëvendësimet**

Zëvendësimi i materialete të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikëqyrësit të Punimeve. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

#### **1.12. Dokumentat dhe vizatimet**

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialete dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jetet nga Punëdhënësi nëse gabime të tillë ose mospërputhje do të zbulohen.



### **1.13. Fotografitë e sheshit të ndërtimit**

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demostruar kushtet e objektit përparrë fillimit, progresin gjatë punës së konservimit dhe mbas përfundimit të punimeve restauruese.

### **1.14. Bashkëpunimi në zonë**

Restaurimi do të bëhet në zona të kufizuara. Kontraktori duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- a. Nevojën për të mirëmbajtj shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për punonjësit, gjatë periudhës së restaurimit të urës.

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundëshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij si dhe stafin e Punëdhënësit.

Në përgatitjen e programit te tij të punës, Kontraktori gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të kooperojë me programin e punës se Kontraktorëve të tjera, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

### **1.15. Mbrojtja e punës dhe e publikut**

Kontraktori do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të punimeve. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Kontraktori duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tillë dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

### **1.16. Mbrojtja e ambjentit**

Kontraktori duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujtit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

### **1.17. Transporti dhe magazinimi i materialeve**

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar gjithashtu dhe me kafshë pune. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të



stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

### 1.18. Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

## SEKSIONI 2. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

### 2. TË PËRGJITHSHME

**KËRKESAT:** Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuara ose të specifikuara. Punimet e cto nuk do të fillojnë deri sa autorizimi te merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja apo çmontimi, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura per sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjeherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asnjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbikqyrësit.

#### Mbrojtja e vendit të pastruar

Sipërmarësi i punimeve duhet të ngrëjë rrjetë të përshtatshme, bariera mbrojtëse, në mënyrë që të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialet që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

#### Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të janë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të janë konform të gjitha kushtet teknike.

### 2.1 PUNIME PRISHJEJE

PROJEKT RESTAURIMI URA E GLINËS NË FSHATIN GRAPSH, DROPULL I POSHTËM



### **2.1.1 Skeleritë:**

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të janë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të janë konform të gjitha kushteve teknike.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

### **2.1.2 Mbikqyrja**

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

### **2.1.3 Metoda e prishjes**

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të janë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të janë të tillë që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdeshshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

## **2.2 PASTRIMI I KANTIERIT**

### **2.2.1 Pastrimi i kantierit:**



Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirjet e mbeturinave të tjera.

#### *2.2.2 Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:*

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojë strukturat që gjenden në afersi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji.

Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

#### *2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:*

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, bariera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

### **SEKSIONI 3. NDËRHÝRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE**

#### **3.1 TË PËRGJITHSHME**

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në K.KT.K.M. si dhe parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit” – VKM Nr.426 on 13 Korrik 2007.

#### **3.2 NDËRHÝRJET NË “MONUMENTET E KULTURËS”**

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfollogjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llojikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

#### **3.3 SPECIFIKIMET E NDËRHÝRJEVE RESTAURUESE**



## I. PUNIME SKELERI-TRANSPORT

### 1.1 Skelë me tubo për të kryer punimet e fugatimit dhe pastrimit ~ 8m (R.124)

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Ky çmim përfshin ndërtimin e skelës për të realizuar punimet poshte qemereve te ures. Në mënyrë që skela të krijojë siguri duhet të jetë metalike, tubolare dhe e kolauduar brenda vitit të fundit.

*Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m<sup>2</sup>.*

### 1.2 Skelë fasade (R.124/1)

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Ky çmim përfshin ndërtimin e skelës përgjatë gjithë fasadës jashtme të objektit për të realizuar të gjithë punimet në muraturë. Në mënyrë që skela të krijojë siguri duhet të jetë metalike, tubolare dhe e kolauduar brenda vitit të fundit.

*Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m<sup>2</sup>.*

### 1.3 Transport materiale ndërtimi, dheu dhe mbeturina me auto deri në 10.0 km (2.37/5b)

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjeti i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 10 km larg nga kantieri.

*Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m<sup>3</sup>.*



## II. PUNIME RESTAURIMI

### 2.1 Sondazh për themele (gërmim për verifikimin e thellësisë së themeleve) (R.3)

Ky çmim prashikon sondazh në zonat ku do të bëhet gërmim dheu për të evidentuar gjurmët e strukturës dhe për të verifikuar thellësinë dhe gjendjen e themeleve ne kembet e ures. Sondazhet do të bëhen në pikat e paraqitura në fletë teknike.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ m<sup>3</sup>.*

### 2.2 Restaurim dhe plotësim i murit të gurit llaç gëlqere 1:3 tek të dy shpatullat e urës (R.17)

#### Përshkrimi:

Plotësim i elementëve të gurit që mungojnë në dy shpatullat e urës, ne dy anet e ures ku verehet mungesa e tyre, me material të ri dhe llaç analog në rezistencë me originalin.

#### Ndërtimi i muraturës:

Do të bëhet plotësim i shpatullave të urës me material guri gëlqeror, , të cilët do të vendosen në vepër, me të njëjtën teknikë si muri ekzistues, ndërsa bërtama e përbërë nga po i njëjti material prej guri gëlqeror por me copa më të vogla dhe të vendosura në mënyrë të çrrëgullt.

#### Fazat e ndërhyrjes


Përpara se të rindërtojmë muraturën ndërmarrim disa veprime sigurie.

- 1) Puna fillon me ëin dhe sistemimin e materialit ekzistues në vepër,
- 2) me kujdes mbledhim gurët e paretit të jashtëm në mënyrë që të kemi mundësi ti ripërdorim për të ruajtur të njëjtën tipologji murature në sipërfaqe,
- 3) duke pastruar terrenin shohim deri në cilën shkallë ka arritur dëmtimi i muraturës ekzistuese,
- 4) vazhdojmë me fazat e rindërtimit të muraturës.

*Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m<sup>3</sup>.*

### 2.3 Konsolidim strukturor i muraturës prej guri me teknikën e injektimit të mishelës me rezistencë të lartë mekanike dhe përbërje të ulët të kripave të tretshme në ujë . (R.22)

Punimi përfshin injektimin me presion të ulët në brendësi të muraturës të një përzjerje të rrjedhshme (mishelë fluide). Injektimi i mishelave lidhëse në brendësi të muraturës është një teknikë që ka për qëllim përmirësimin e karakteristikave të muraturës që paraqitet e degraduar (në veçanti homogenitetin dhe rezistencën mekanike). Me anë të kësaj teknike synohet të rritet rezistenca e muraturës në vetvete duke mos ndryshuar ekuilibrin egzistues dhe pamjen origjinale të murit që do të konsolidohet. Injektimi do te realizohet me makineri specifike ne te cilen komandohet presioni i injektimit. Kryesisht injektimi do te realizohet ne kembet e ures ku kemi



mungese te materialit lidhes.

**Fazat e zbatimit të injektimit për konsolidimin e muraturës ekzistuese.**

1. Përgatitja e sipërfaqes. (pastrimi i fugave në mënyrë mekanike me furçë teli dhe larja e muraturës me ujë për eleminimin e substancave të mundshme - për muraturën e degraduar përdoret uji i nebulizuar).
2. Mbyllja e fugave (për të evitar rrjedhjen e mishelës) nëpërmjet stukimit me lidhës në përputhje me mishelen e injektuar. Do përdoret një llaç me bazë të gëlqeres hidraulike natyrale dhe rere vullkanike.
3. Realizimi i rrjetit të injektimit. Vlerësimi në funksion të nivelit të degradimit, të trashësisë të murit. Bëhet performimi i paretit ( $2-4$  vrima për  $m^2$ ) me diametër  $\varphi 1.5-2.5\text{cm}$ .
4. Pozicionimi i tubave ( $\varphi 1-2\text{ cm}$ ), me thellësi max  $30\text{cm}$ . Organizohet kryesisht në kulme të një rrjeti me trekëndësha barabrinjës, zgjatet me rreth  $20\text{cm}$  nga paresi dhe thellësi mesatare prej  $25-30\text{ cm}$ .
5. Larja dhe njomja e muraturës: larja nëpërmjet tubave për eleminimin e copërave të hapjes së vrimave, verifikimin e rrugëve të injektimit, reduktimin e absorbimit të ujit të përzierjes (mishelës) për të mos reduktuar hidratimin dhe rrjedhshmërinë e përzierjes.
6. Injektimi me presion të ulët i mishelës. Llaçi i injektimit do të përbëhet prej materialesh tradicionale dhe me rezistencë jo më të madhe se llaçi i shëndoshë i muraturës, për të shmangur rrezikun e krijimit të bërthamave rigjide brenda masës së muraturës. Injektimi do të kryhet makineri, duke filluar nga pjesët e poshtme të muraturës dhe duke u ngjitur në lartësi.
7. Heqja e tubave dhe stukimi i vrimave.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/ $m^3$ .

**2.4 Fugatim në qemere guri dhe muraturë (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim) (R.25)**

Fugat që do ti nënshtrohen këtij procesi, do të evidentohen plotësisht vetëm pasi të jetë bërë pastrimi i vegjetacionit nga sipërfaqja e strukturës. Do të fugatohen të gjithë pjesët e muraturës, sipërfaqet e strukturës ku ka vegjetacion, si dhe pjesët ku materiali lidhës është i degraduar.

Pasi të pastrohet vegjetacioni, muret do të shplahlen me ujë në mënyrë që të ekspozojen llaçi dhe fugat. Pjesët ku ka pasur rrënje si dhe në ato pjesë ku llaçi është i dobët do të pastrohen nga llaçi i degraduar me furçë të butë teli dhe pasi të pastrohen nga të gjitha mbetjet organike do të rimbushen me llaç të ri. Fugat duhet të mbushen deri në planin e murit, që të krijojë sipërfaqe të njëjtë me tipin e fugatimit të përdorur në teknikën origjinale të muraturës ekzistuese dhe që në asnjë rast të mos ndodhë mbajtja e ujit apo dherave që sjell era.

Në çmim përfshihet, transporti i materialeve dhe gjithcka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/ $m^2$ .



## **2.5 Restaurim kalldrëmi (R.66)**

Restaurimi i kalldremit në pjesët ku evidentohen pjeset ku ka cedim te kalldremit dhe thyerje te gureve te tij. Nderhyrja do te realizohet ne pjeset e parashikuara sipas fletëve grafike dhe kontrollit pas heqjes se vegjetacionit , do të realizohet me gur gelqeror, me te njejten tipologji si gurët origjinal ekzistues. Ngulja e gureve do të bëhet duke i ngjeshur mirë pranë njeri tjetrit mbi një shtrese rere, dhe mbushja me një shtrese rëre lumi të pa situr dhe të pa larë më parë.

*Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m<sup>2</sup>.*

## **2.6 Shtresë kalldrëmi 15-20cm mbi shtresë rëre (R.65)**

Plotësimi i kalldremit në pjesët ku evidentohen pjeset ku ka mungesë kalldrëmi. Nderhyrja do te realizohet ne pjeset e parashikuara sipas fletëve grafike dhe kontrollit pas heqjes se vegjetacionit, do të realizohet me gur gelqeror, me te njejten tipologji si gurët origjinal ekzistues. Ngulja e gureve do të bëhet duke i ngjeshur mirë pranë njeri tjetrit mbi një shtrese rëre lumi të pa situr dhe të pa larë më parë.

*Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m<sup>2</sup>.*

## **2.7 Shtresë rëre**

Ky zë përfshin blerjen e materialit të rërës si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e rërës është parashikuar të vendoset si shtresë për vendosjen e kalldrëmit. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës ne pjeset ku do te hapet kalldremi dhe ne pjeset qe do te shohim cedim te kalldremit.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ m<sup>3</sup>*

## **2.8 Restaurimi dhe plotësimi i bordurave anesore të guri 20\*10 cm lidhur me llaç gëlqere (R.75)**

Ky çmim përfshin restaurimin dhe vendosjen e gureve ne pjeset e siperme te shpatullave të urës të cilët janë të dëmtuar, plotësimi i tyre me gurë të ngajashëm në përmasa dhe përberje me ata ekzistues. I gjithë ky proces do të bëhet pasi të kemi konsoliduar të gjithë muraturën ekzistuese të rrënuar, aty ku shohim që ka deformime si dhe shkëputje të materialit, guret do te fiksohen me material llac-gelqere hidraulike.

Restaurimi i kesaj pjese do të kryhet në praninë e mbikqyrësit të punimeve që të jenë në përputhje në plotë me kërkzesat e projektit lidhur me materialin, dimensionet, etj.

*Ky çmim është lekë/ml.*

## **III. PUNIME SISTEMIM TERRITORI**

### **3.1 Sistemim territori, gërmim e transport dhei me k. Dore (R.1)**

Ky çmim parashikon gërmimin e dherave aty ku është e nevojshme dhe ku është e parashikuar



në projekt. Kjo ndërhyrje do të bëhet me qëllim nivelimin e territorit dhe heqjen e sasisë së baltës të cilën e ka sjellë uji dhe mbeturinave në teritor të cilat dhe kanë mbuluar pjesën më të madhe të këmbëve të urës. Largimi i baltës do të bëhet mekanikisht.

#### Mbrojtja e punimeve të dheut.

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit.

Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrithimi (me gardh, rrjetë gabant, etj.) i cili nuk i lejon ata të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrithimit nga persona që nuk punojnë në projekt.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ m<sup>3</sup>.*

#### **3.2 Pastrimi nga bimësia e ulët në kalldrëm dhe mure (R.5)**

Ky çmim përfshin pastrimin e kalldrëmit dhe muraturës nga bimësia e ulët. Vegetacioni i ulët ka nevojë për ndërhyrje në të dyja ciklet e zhvillimit, pranverë dhe vjeshtë. Trajtimi i tij do të bëhet në bazë të aspektit të zhvillimit. Në strukturat ku vegetacioni është i rrallë do të përdoret ëi mekanik i tij, duke e eleminuar vegetacionin me githë rrënje.

Pas eleminimit përfundimtar të vegetacionit, është e nevojshme që të bëhet fugatimi i strukturave. (si realizohet ky proces, është trajtuar në paragrafët paraardhës).

Në rastet kur trungu/kërcelli ka diametër më të madh se 4 cm atëherë pasi të bëhet prerja do të përdoret mënyra e injektimit të herbicidit si tek pemët e larta.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ m<sup>2</sup>.*

#### **3.3 Pastrimi nga bimësia e ulët + injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija në muraturë (R.5/1).**

Ky çmim përfshim pastrimin e muraturës nga bimësia e ulët si dhe injektimin e herbicideve për tharjen e bimësise në brendësi të muraturës. Procesi punës përfshin prerje në mënyrë mekanike e vegetacionit dhe rrënjeve, pastrimin e tij në brendësi të muraturës deri aty ku është e mundur dhe tharjen e rrënjeve të cilat janë shumë të vështira për tu hequr mekanikisht, me injektim. Injektimi do të realizohet, nëse trungu/kërcelli ka diametër më të madh se 4 cm, bëhet prerja dhe më pas do të përdoret mënyra e injektimit të herbicidit si tek pemët e larta.

Pas eleminimit përfundimtar të vegetacionit, është e nevojshme që të bëhet fugatimi i strukturave. (si realizohet ky proces, është trajtuar në paragrafët paraardhës).

*Ky çmim është për njësi Lekë/ m<sup>2</sup>.*

#### **3.4 Prerje dhe tharrje të rrënjeve masive(raundap 200cc) (R.5/2)**

Ky çmim përfshim heqjen e pemëve që ndodhen në du skajet e urës , dhe procesi punës përfshin prerje në mënyrë mekanike e rrënjeve, pastrim të vegetacionit në brendësi të muraturës dhe tharjen e rrënjeve të cilat janë shumë të vështira për tu hequr mekanikisht. Tharja e tyre do të realizohet me spërkatjen më herbicid.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.*



### **3.5 F.v tabelë informacioni me bazament (An.159)**

Ky çmim përfshin furnizimin dhe vendosjen e një paneli informues mbi monumentin. Paneli do të vendoset në pozicionin e paraqitur në projekt, do të përfshijë informacione të përgjithshme dhe do të jetë në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Formati i panelit informues do të jetë 90 x 60 cm. Paneli është me kornizë metalike ndërsa formati adeziv nën plexiglass. Vendosja e panelit informues do të realizohet në bashkëpunim me Investitorin, pas konsultave në vend.

*Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.*

#### **Përgatiti Grupi i punës:**

Ark. Arta Dollani

Ark. Daniel Pirushi

Ing. Denisa Shehu

Ing. Endrita Mulleti

Ark. Llambrino Baballëku

Ark. Rudina Papavasili

Ark. Artila Vavako

Ark. Joli Mitrojorgji

Artila  
Vavako

Digitally signed by  
Artila Vavako  
Date: 2021.02.08  
01:45:22 +02'00'

Denisa  
Shehu

Digitally signed by  
Denisa Shehu  
Date: 2021.02.09  
09:40:43 +02'00'

Daniel  
Pirushi

Digitally signed by  
Daniel Pirushi  
Date: 2021.02.09  
09:43:07 +02'00'

Joli  
Mitrojorgj

Digitally signed by Joli  
Mitrojorgj  
Date: 2021.02.09  
10:37:40 +02'00'

PROJEKT RESTAURIMI URA E GLINES NË FSHATIN GRAPSHI DROPULL I POSHTËM  
Arta Dollani Rudina Papavasili Endrita Mulleti

Digitally signed by Arta  
Dollani  
Date: 2021.02.09  
03:12:23 +02'00'

Digitally signed by  
Rudina Papavasili  
Date: 2021.02.09  
10:29:00 +02'00'

Digitally signed by  
Endrita Mulleti  
Date: 2021.02.09  
03:25:18 +02'00'

